



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Projekt LIGJ

Nr. _____, datë _____

PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË UJËRAVE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 e Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka si qëllim të përcaktojë:

- a) një kuadër të plotë për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit të ujërave sipërfaqësorë të brendshëm, të ujërave të përkohshëm, të ujërave bregdetare, të ujërave nëntokësore dhe të statusit të tyre;

¹ Ky ligj transponon:

32000L0060 - Direktivën 2000/60/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 23 Tetorit 2000 që krijon kuadrin për veprimin e Komunitetit në fushën e politikës për ujërat, amenduar me Vendimin 2455/2001/EC, Direktivën 2008/32/EC dhe Direktivën 2008/105/EC.

dhe

32006L0118 - Direktivën 2006/118/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi, dhe Direktivën 2007/60/EC për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet.

- c) metodat dhe kushtet për menaxhimin e integruar dhe përdorimin racional të burimeve ujore, mbrojtjen e cilësisë ekologjike të ujërave dhe ndalimin e përkeqësimit, sistemimin e rrjedhave dhe trupave të tjerë ujorë, si dhe parandalimin e ndotjes së ujërave; mënyrën e organizimit, ushtrimit dhe funksioneve të autoriteteve të menaxhimit të ujërave; kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave, KKKU-së, Ministrisë, të organeve të tjera në nivel qendror e vendor dhe të subjekteve të tjera juridike, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për menaxhimin e ujërave.

Neni 2 **Objekti i ligjit**

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:
 - a) ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, ujërat e brendshme detare, burimet natyrale dhe ujërat e lagunave, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore së bashku me shtresat ujëmbajtëse dhe reshjet atmosferike nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë;
 - b) ujërat minerale dhe termale, me përjashtim të ujërave minerale dhe gjeotermale që janë të përshtatshme për nxjerrjen e lëndëve të para minerale ose shfrytëzimin e energjisë termike të akumuluar për qëllime të prodhimit të energjisë, të cilat rregullohen me legjislacion të veçantë.
2. Vija kufitare që ndan ujërat tokësore nga ato bregdetare përcaktohet me akte ligjore e nënligjore të veçanta.

Neni 3 **Përkufizimi i termave**

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Agjencia Kombëtare e Mjedisit”** ka kuptimin e dhënë në ligjin nr... dt... “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
2. **“Agjencia Rajonale e Mjedisit”** është njësi rajonale përkatëse e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
3. **“Autoritetet e ujit”** janë autoritetet e listuara në nenin 7 të këtij ligji.
4. **“Autoriteti perkates i Qeverisjes Vendore”** është njësi e qeverisjes vendore në territorin e së cilës kryhet veprimtaria lidhur me ujërat.
5. **“Autorizim”** është akti administrativ, sic përcaktohet në ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
6. **“Baseni lumor”** është sipërfaqja e tokës prej ku, përmes një numri përrenjsh, lumenjsh apo edhe liqenesh, të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen në një lumë, i cili derdhet në det në një grykëderdhje të gjerë të vetme, në një deltë, apo në një lumë tjetër.
7. **“Brigjet”** janë rripa anësore të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve, që në funksion të përdorimit përfshijnë të paktën dy zona:
 - a) **me gjerësi 5 m** në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrët dhe 20 m nga vija e nivelit maksimal 25-vjeçar të ujit në brigjet e sheshta, që përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta;

- b) me gjerësi 100 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror në brigjet e pjerrëta dhe 200 m nga vija e nivelit maksimal 25-vjeçar të ujit në brigjet e sheshta, në të cilën çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga autoritetet e ujit.
- Kufiri i ndarjes së bregut të pjerrët me bregun e sheshtë është pjerrësia 10 për qind në drejtim normal me bregun.
8. **“Burimet ujore” përbëhen nga** ujërat sipërfaqesore dhe burimet natyrale, ujërat bregdetare, tranzitore dhe ujërat nëntokësore.
 9. **“Enti Rregullator i Ujit”** shkurtimisht “ERRU” është Institucioni që ushtron veprimtarinë në bazë të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1999, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar.
 10. **“Inspektorati Kombëtar i Mjedisit”** është autoriteti inspektues sipas përcaktimit të dhënë në Ligjin Nr... Dt... “Për mbrojtjen e mjedisit”.
 11. **“KKU”** është shkurtim për Këshilli Kombëtar i Ujërave.
 12. **“Konçesion”** është marrëveshja, pavarësisht nga emri që i jepet, ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit sic përcaktohet në ligjin Nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për Koncesionet” i ndryshuar.
 13. **“Kontrollet e shkarkimeve”** janë kontrollet që i bëhen shkarkimeve në lidhje me shkarkimet specifike kufi, me një normë teknike shkarkimesh në mjedis, ose me një normë që specifikon kufijtë ose kushtet mbi efektet, natyrën ose kushte të tjera që ndikojnë mbi shkarkimet.
 14. **“Leje mjedisi”** është leja e mjedisit e tipit A, B, apo C sipas rastit, siç përcaktohet në Ligjin Nr.____, datë_____ “Për Lejet e Mjedisit”.
 15. **“Leje”** është akti administrativ, sic përcaktohet në ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
 16. **“Licencë”** është akti administrativ, sic përcaktohet në ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
 17. **“Ligji për mbrojtjen e mjedisit”** është Ligji Nr____, datë_____ “Për mbrojtjen e mjedisit”.
 18. **“Liqen”** është një trup me ujëra të brendshëm sipërfaqësore dhe/ose nëntokësore
 19. **“Lumë”** është një trup ujor i brendshëm, me ujë që në pjesën më të madhe të tij rrjedh mbi sipërfaqen e tokës, por që në një pjesë të rrjedhës së tij mund të rrjedhë edhe nëntokë.
 20. **“Ministër përgjegjës”** është ministri që mbulon fushën e veprimtarisë, sipas përcaktimit të legjislationit në fuqi.
 21. **“Ministri”** është Ministri i Ministrisë përgjegjëse për menaxhimin e ujërave.
 22. **“Ministria”** është ministria përgjegjëse për menaxhimin e ujërave.
 23. **“Mjedis”** ka kuptimin e dhënë në ligjin nr... dt... “Për mbrojtjen e mjedisit”.
 24. **“Ndotje”** ka kuptimin e dhënë në ligjin nr____datë _____”Per mbrojtjen e mjedisit”.
 25. **“Normë e cilësisë së mjedisit për ujërat”** është përqendrimi i një substance ndotëse të veçantë ose i një grupi substancash ndotëse në ujë, në sedimente ose në biotë, i cili nuk duhet të tejkalohet me qëllim që të mbrohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi.
 26. **“Normë e cilësisë së ujërave nëntokësore”** është norme mjedisore, teknike dhe shëndetësore që shprehet si përqendrim i një substance ndotëse të veçantë apo i një

grupi substancash ndotëse, apo si tregues i ndotjes së ujërave nëntokësore, që nuk duhet të tejkalohet me qëllim që të mbrohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi.

27. **“Normë teknike e shkarkimit në mjedis”** ka kuptimin që i është dhënë nga Ligji “Për mbrojtjen e mjedisit”.
28. **“Objektiva mjedisore”** janë ato objektiva që përcaktohen në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin të veçantë.
29. **“Operator”** është personi fizik apo juridik që operon, përdor, shkarkon, trajton apo kryen çdo lloj aktiviteti tjetër në fushën e menaxhimit të ujërave në përputhje me legjislacionin në fuqi.
30. **“Përmbytja”** është mbulimi i përkohshëm nga uji i një toke që normalisht nuk mbulohet nga uji. Kjo përfshin përmbytjet nga lumenjtë, përrrenjtë malorë, nga shkarkimet e digave, rrjedhat ujore kalimtare dhe përmbytjet nga deti në zonat bregdetare, me përjashtim të përmbytjeve nga sistemet e kanalizimit të ujërave të zeza.
31. **“Potencial i mire ekologjik”** është potenciali ekologjik i një trupi ujqor tepër të modifikuar ose i një trupi ujqor artificial, kur ai vlerësohet po aq ‘i mirë’, sa është përcaktuar në akte ligjore të vecanta.
32. **“QKL”** është shkurtimi i “Qendra Kombëtare e Licencimit” që nënkupton institucionin përkatës sipas përcaktimit të ligjit Nr. 10081, dt. 23.02.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
33. **“Regjistër Kombëtar i Liçencave dhe Lejeve”** është një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural publikimi/ shpalljeje dhe si arkiv elektronik zyrtar dhe që siguron transparencën në fushën e licencimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.
34. **“Regjistër Kombëtar i Ujërave”** është një inventar publik që mbahet në mënyrë elektronike dhe në letër, ku regjistrohen të gjitha të dhënat rreth burimeve ujore.
35. **“Rrethi i basenit lumor”** është pjesa e tokës dhe e detit që përbëhet nga një ose më shumë basene lumenjsh fqinjë dhe ujërat e tyre nëntokësore dhe bregdetare, e cila identifikohet si njësi kryesore administrative për menaxhimin e ujërave të baseneve të lumenjve.
36. **“Rreziku nga përmbytjet”** është kombinimi i probabilitetit të ngjarjes së përmbytjes dhe të pasojave negative të mundshme për shëndetin e njeriut, për gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik që lidhet me ngjarjen e përmbytjes.
37. **“Servitut”** ka kuptimin që i jepet nga dispozitat e Kodit Civil të RSH.
38. **“Shërbimet e ujit”** janë të gjitha shërbimet që sigurojnë për konsumatorët familjarë, publikë e privatë, si dhe për veprimtaritë e biznesit, nxjerrjen, mbajtjen, ruajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit sipërfaqësor ose nëntokësor, grumbullimin, largimin dhe perpunimin e ujerave të ndotur, të cilat më pas shkarkojnë në uje.
39. **“Shkarkim në ujë”** nënkupton shkarkimet në trupat ujore ku përfshihen shkarkimet në rrjetin e tubacioneve të ujërave të ndotura dhe të bardha;
40. **“Sistemi i kanalizimeve”** ka kuptimin që i jepet nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a.”

41. **“Status ekologjik”** është shprehje e cilësisë së strukturës dhe funksionimit të ekosistemeve ujore që lidhen me ujërat sipërfaqësore dhe klasifikohet në përputhje me akte të veçanta ligjore.
42. **“Status i mirë ekologjik”** është statusi ekologjik i arritur nga një trup ujqor sipërfaqësor që vlerësohet po aq ‘i mirë’, sa është përcaktuar në akte të vecanta ligjore.
43. **“Status i mirë i ujërave nëntokësore”** është statusi i arritur nga një trup me ujëra nëntokësore, kur si statusi i tij sasior, **ashtu edhe statusi i tij kimik vlerësohen të paktën** po aq ‘të mirë’ siç përcaktohet në standardet shtetërore të miratuara.
44. **“Status i mirë i ujërave sipërfaqësore”** është gjendja e arritur nga një trup ujqor sipërfaqësor, kur si gjendja e tij ekologjik ashtu edhe gjendja e tij kimik janë vlerësuar të paktën po aq ‘të mirë’, siç përcaktohet në standardet shtetërore të miratuara.
45. **“Status i mirë kimik i ujërave nëntokësore”** është statusi kimik i një trupi ujqor nëntokësor që vlerësohet po aq ‘i mirë’, siç përcaktohet në ne standardet shtetërore të miratuara.
46. **“Status i mirë kimik i ujërave sipërfaqësore”** është statusi kimik që kërkohet për të përmbushur objektivat mjedisore për ujërat sipërfaqësore, siç përcaktohet në standardet shtetërore të miratuara.
47. **“Status i mirë sasior i ujërave nëntokësore”** është statusi sasior i një trupi ujqor nëntokësor që vlerësohet po aq ‘i mirë’, siç përcaktohet në standardet shtetërore të miratuara.
48. **“Status i ujërave nëntokësore”** është shprehja e përgjithshme e statusit të një trupi ujqor nëntokësor, që përcaktohet nga statusi referuar limiteve të sipërme të standardit siç përcaktohet në standardet shtetërore të miratuara.
49. **“Status i ujërave sipërfaqësore”** është shprehje e përgjithshme e gjendjes së një trupi ujqor sipërfaqësor, që përcaktohet nga gjendja e tij ekologjike, cilësore dhe kimike më e varfër.
50. **“Status sasior”** është shprehje e masës në të cilën një trup ujqor nëntokësor ndikohet nga nxjerrjet e drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta.
51. **“STKKU”** është shkurtim i “Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave”.
52. **“Subjekt i kompetencave të përbashkëta”** është enti, bordi, institucioni ose komiteti që krijohet nga një ose më shumë autoritete vendore dhe/ose kombëtare për të përmbushur së bashku detyrat ose përgjegjësitë në përputhje me këtë ligj.
53. **“Subjekt ndotës”** ka kuptimin që i është dhënë nga Ligji nr... dt...“Për mbrojtjen e mjedisit”.
54. **“Substanca ndotëse”** janë të gjitha substancat e prirura për të shkaktuar ndotje, në veçanti ato që janë përcaktuar si të tilla në akte ligjore e nënligjore specifike.
55. **“Substanca prioritare”** janë ato substanca që përfshijnë “substancat prioritare të rrezikshme” që përcaktohen në akte ligjore të vecanta, për ndalimin apo ndërprerjen e shkarkimeve, clirimeve dhe humbjeve të të cilave duhen marrë masa të posaçme.
56. **“Substanca të rrezikshme”** ka kuptimin që i është dhënë nga Ligji nr... dt... “Për mbrojtjen e mjedisit”.
57. **“Ujërat e ndotura industriale”** janë të gjitha ujërat e përdorura që shkarkohen nga mjediset që përdoren për të zhvilluar veprimtari tregëtare ose industriale, të cilat nuk janë ujëra të përdorura shtëpiake apo rrjedha të ujërave të shirave.

58. **"Ujërat e ndotura shtëpiake"** janë ujërat e përdorura nga zonat rezidenciale dhe sektori i shërbimeve që e kanë origjinën kryesisht nga metabolizmi i njeriut dhe veprimtaritë e sektorit shtëpiake.
59. **"Ujërat e ndotura urbane"** janë ujërat e përdorura shtëpiake ose një përzierje e ujërave shtëpiake me ujëra të ndotura industriale dhe/ose rrjedhat nga ujërat e shirave.
60. **"Titullar i licencës/ autorizimit/ lejes/ koncesionit"** është personi juridik apo personi fizik, që ka marrë një licencë, autorizim, leje apo koncesion.
61. **"Trup me ujëra nëntokësore"** quhet ai formacion gjeologjik që ka aftësinë e ujembajtjes në një vëllim dhe kusht të caktuar dhe që perben një akuifer.
62. **"Trup ujqor artificial"** është trupi ujqor sipërfaqësor i krijuar nga veprimtaria njerëzore si rezervuar, depo ruajtjeje, kanal, pellg për rritje peshku, etj;
63. **"Trup ujqor sipërfaqësor"** është një element i dallueshëm dhe i rëndësishëm i ujërave sipërfaqësore, psh. një liqen, rezervuar, përrua, lumë ose kanal, një pjesë e një përroi, lumi ose kanali, ujëra tranzitore ose një shtrirje e ujit bregdetar.
64. **"Trup ujqor tepër i modifikuar"** është trupi ujqor sipërfaqësor, i cili si rezultat i ndryshimeve fizike nga aktiviteti njerëzor ka ndryshuar rrënjësisht karakterin e tij në krahasim me atë që është shpallur me legjislacionin përkatës nga autoriteti kompetent.
65. **"Ujë i pijshëm"** është uji i destinuar për konsum njerëzor dhe ka të njëjtin kuptim që i jepet nga Direktiva 80/778/EEC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, e ndryshuar nga Direktiva 98/83/EC.
66. **"Ujëra bregdetare"** janë ujërat sipërfaqësore të cilat ndodhen në brendësi të një vijë imagjinare e cila është e baraslarguar në secilin nga pikat e saj 1 milje detare nga pjesa e jashtme e pikës me të afërt të vijës baze dhe që shërben si referim për të përcaktuar shtrirjen e ujërave territoriale dhe që shtrihen eventualisht deri në kufirin e jashtëm të ujërave tranzitore.
67. **"Ujëra nëntokësore"** janë të gjitha ujërat që ndodhen nën sipërfaqen e tokës në zonën e ngopjes dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me tokën ose me nëntokën.
68. **"Ujëra të brendshme"** janë të gjithë ujërat sipërfaqësore të rrjedhshme ose jo, dhe të gjitha ujërat nëntokësore në pjesën e brendshme të vijës baze që shërben si pikë referimi për përcaktimin e ujërave territoriale.
69. **"Ujëra tranzitore"** janë trupa ujqorë sipërfaqësorë në afërsi të grykëderdhjeve të lumenjve në det, që janë pjesërisht me karakter të kripur si rezultat i afërsisë së tyre me ujërat bregdetare, por që kryesisht influencohen nga rrjedha me ujëra të ëmbla.
70. **"Ujërat sipërfaqësore"** janë ujërat e brendshme me përjashtim të ujërave nëntokësore, ujërat tranzitorë dhe ujërat bregdetare dhe ujërat territoriale, përveç sa i takon statusit kimik të këtyre të fundit.
71. **"Zone e vershimit"** është sipërfaqja në të dy anët e shtreterve të lumit ku parashikohet të ndodhin përmbajtje të perkohshme.

Neni 4 Pronësia e shtetit

1. Pronësia e Shtetit përbëhet nga:
 - a) Të gjitha burimet ujore të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në pikën 1/a) të nenit 2 të këtij ligji;

- b) Të gjithë shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrenjve dhe rrjedhave të tjera natyrore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, kanalet, liqenet, pellgjet, lagunat dhe ujëmbledhësit natyrore apo artificiale, ishujt dhe akumulimet e rërës, gurëve dhe llumrave nga shtretërit e lumenjve, liqeneve dhe ujëmbledhësve, si dhe formacionet gjeologjike të ujërave nëntokësore;
 - c) Të gjitha strukturat dhe punimet hidro-teknike të realizuara nga shteti si digat, sistemet e ujitjes, kullimit dhe lundrimit, stacionet e ujit të pijshëm dhe kanalet dhe punimet që lidhen me to;
 - d) Toka e përftuar nga tërheqja e ujit ose nga përparimi i tokës në drejtim të ujit kur ajo lidhet me tokën, që është në pronësi të shtetit.
2. E drejta e pronësisë së shtetit siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni, është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.

Neni 5

Menaxhimi i integruar i ujërave

1. Qëllimi kryesor i menaxhimit të integruar të ujërave është krijimi i një kuadri për mbrojtjen e burimeve ujore me qëllim:
- a) Monitorimin e statusit të ujërave, përdorimin racional dhe pakesimin e ndotjes;
 - b) parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm, mbrojtjen dhe përmirësimin e statusit të ekosistemeve ujore dhe, për shkak të nevojave të tyre për ujë, të ekosistemeve tokësore dhe ligatinave që varen drejtpërdrejt nga ekosistemet ujore;
 - c) promovimin e përdorimit racional e të qëndrueshëm të ujit bazuar në mbrojtjen afatgjatë të burimeve ujore të disponueshme;
 - d) forcimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit ujor përmes masave të posacme për reduktimin progresiv të shkarkimeve, clirimeve dhe humbjeve të substancave prioritare, ndalimin ose mënjanimin gradual të shkarkimeve, dhe humbjeve të substancave prioritare;
 - e) sigurimin e reduktimit progresiv të ndotjes së ujërave nëntokësore dhe parandalimin e ndotjes së mëtejshme të tyre;
 - f) zbutjen e efekteve të përmytjeve dhe të thatësisë.
2. Menaxhimi i integruar i ujërave kontribuon në mënyrë të veçantë për:
- a) sigurimin e një sasive të mjaftueshme ujërash sipërfaqësore dhe nëntokësore me cilësi të mirë të nevojshme për një përdorim të qëndrueshëm, të balancuar dhe të drejtë të ujit;
 - b) reduktimin e ndjeshëm të ndotjes së ujërave nëntokësore;
 - c) mbrojtjen e ujërave territoriale dhe detare;
 - d) arritjen e objektivave në përputhje me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë edhe ato që synojnë të parandalojnë dhe t'i japin fund ndotjes së mjedisit detar.

Neni 6

Parimet e menaxhimit të integruar të ujërave

Menaxhimi i integruar i ujërave bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) Respektimi i integritetit të baseneve lumorë, bazuar në kërkesat sociale dhe ekonomike për burime ujore, duke mbrojtur dhe ruajtur cilësinë e këtyre burimeve dhe cilësinë e mjedisit për brezat e ardhshëm.
- b) Koordinimi i kontrollit publik mbi burimet ujore përmes planifikimit të territorit dhe projekteve të zhvillimit social ekonomik në nivel kombëtar dhe vendor;
- c) Shfrytëzimi racional i burimeve ujore dhe kontrolli i shkarkimeve;
- d) Respektimi i parimit të rikuperimit të kostove të shërbimeve të ujit, duke përfshirë edhe kostot e mjedisit në përputhje me parimin “ndotësi paguan”;
- e) Parimi “ndotësi paguan” sipas të cilit shpenzimet e shkaktuara nga ndotja e ujit mbulohen nga subjekti ndotës;
- f) Parimet e mbrojtjes së mjedisit të përcaktuara në Ligjin nr. ----, datë --- “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- g) Garantimi i një furnizimi të mjaftueshëm të ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësorë me cilësi të mirë për një përdorim ujqor të qëndrueshëm, të ekuilibruar dhe të barabartë.

KREU 2

AUTORITETET E MENAXHIMIT TE BURIMEVE UJORE

Neni 7

Autoritetet e menaxhimit të ujërave

Menaxhimi i burimeve ujore ne RSH kryhet nga:

- a) Kku
- b) Ministria;
- c) STKKU;
- d) Këshillat e baseneve lumorë;
- e) Agjencitë e baseneve lumorë;
- f) Organe, institucione dhe ente të tjera publike që menaxhojnë burimet ujore të përcaktuara me akte të tjera ligjore e nënligjore.

Neni 8

Autoritetet kombëtare për menaxhimin ujërave

Autoritetet kombëtare për menaxhimin e ujërave janë:

- a) Kku
- b) Ministria;
- c) STKKU.

Neni 9

Këshilli Kombëtar i Ujërave

1. K KU është organi vendimmarrës përgjegjës për menaxhimin e burimeve ujore.
2. K KU është organ ndërministror dhe trajton çështjet e menaxhimit të burimeve ujore.
3. K KU kryesohet nga Kryeministri.

KKU:

- a) i sugjeron dhe i propozon Këshillit të Ministrave akte nënligjore për përmirësimin e legjislacionit për menaxhimin e burimeve ujore;
 - b) përgatit e propozon nëpërmjet Ministrisë, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;
 - c) miraton planet ndër-rajonale dhe kombëtare dhe projektet në fushën e bujqësisë, urbanistikës, zhvillimit industrial e territorial kur ato lidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e ujërave;
 - d) përcakton kufijtë territorialë të zonave të baseneve në të gjithë vendin si dhe qendrën e çdo baseni;
 - e) krijon agjenci ose njësi organizative, në varësi të vet, për të lehtësuar menaxhimin e burimeve ujore dhe zbatimin e këtij ligji;
 - f) propozon dhe merr masat e duhura për zbatimin e çdo marrëveshje ndërkombëtare mbi burimet ujore, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë;
 - g) jep mendim për identifikimin e konçesioneve të mundshme për burimet ujore;
 - h) në rastet kur burimet ujore kanë rëndësi kombëtare, procedurat koncesionare kryhen në përputhje me aktet përkatëse ligjore e nënligjore në fuqi.
4. K KU ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë nga Këshillat e Baseneve Lumorë, ministrinë e tjera, organet, agjencitë dhe entet publike, informacion, të dhëna teknike dhe çdo lloj informacioni që i mundëson K KU-së përgatitjen e strategjisë kombëtare të ujit dhe të planit kombëtar të menaxhimit të burimeve ujore.
 5. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e K KU-së, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 10 Ministria

1. Ministria harton dhe zbaton politika, strategji, programe dhe projekte që synojnë menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ruajtjen sasiore dhe cilësore si dhe konsolidimin e mëtejshëm të tyre.
2. Politikat e Ministrisë orientohen drejt zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve ujore me qëllim rritjen e nivelit ekonomik dhe të cilësisë së jetës së brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

Neni 11 Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të ujit

1. STKKU është organ ekzekutiv i K KU-së.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit miraton mënyrën e organizimit, funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e STKKU-së.

Neni 12

Autoritetet vendore për menaxhimin e ujërave

1. Këshillat e Baseneve Lumore janë autoritetet përgjegjës për menaxhimin e integruar të ujërave të baseneve përkatëse në nivel vendor.
2. Këshilli i Ministrave me akt nenligjor percakton Këshillin e Basenit Lumor për çdo basen ose rreth basenesh lumorë të RSH.
3. Agjencitë e Baseneve Lumorë:
 - a. përgatisin raporte, japin opinione për burimet ujore të basenit përkatës, rekomandojnë marrjen e masave dhe propozojnë projekte për mirëmenaxhimin e burimeve ujore dhe ja paraqesin ato për ndjekje të mëtejshme Këshillave të Baseneve;
 - b. bashkëpunojnë me organet e qeverisjes qendrore e vendore për kryerjen e studimeve e programeve.

Neni 13

Subjekti i kompetencave të përbashkëta

1. Autoritetet Kombëtare dhe Vendore për menaxhimin e ujërave kanë të drejtë të krijojnë subjekte me kompetenca të përbashkëta sipas detyrave të përhershme apo të përkohshme, me detyra dhe përgjegjësi përkatëse për menaxhimin e ujërave.
2. Subjekti me kompetenca të përbashkëta krijohet bazuar në të drejtën e delegimit ose nën delegimit dhe në përputhje me marrëveshjen specifike që nënshkruhet midis palëve.
3. Marrëveshja për themelimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta percakton të paktën:
 - a) qëllimin dhe objektin e themelimit;
 - b) juridiksionin, kompetencat specifike të deleguara dhe aktet që mund të nxirren apo zbatohen;
 - c) përbërjen e organeve që kanë të drejtën për vendim-marrje dhe rregullat e vendim marrjes;
 - d) kohëzgjatjen;
 - e) burimet financiare dhe administrative që jepen për funksionimin e Subjektit nga secila palë e marrëveshjes;
 - f) mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis autoriteteve deleguese.

KREU 3

MENAXHIMI I BURIMEVE UJORE

Seksioni 1

Ndarja e territorit për efekt të menaxhimit të ujërave

Neni 14
Basenet lumore/ Rrethet e baseneve lumore

1. Territori i Republikës së Shqipërisë, për qëllime të menaxhimit të ujërave, ndahet në basene dhe rrethe të baseneve lumorë.
2. Basenet e vogla mund të kombinohen me basenet e mëdha ose të bashkohen me basenet e vogla fqinje për të formuar sipas rastit një basen të vetëm lumor.
3. Ujërat nëntokësore, kur nuk ndjekin plotësisht një basen lumor të vecantë, identifikohen dhe i caktohen rrethit të basenit lumor më të afërt ose më të përshtatshëm.
4. Ujërat bregdetare identifikohen dhe i caktohen rrethit të basenit lumor më të afërt ose më të përshtatshëm.
5. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore menaxhohen në mënyrë të integruar.
6. Kufijtë territoriale hidrografikë të baseneve dhe rretheve të baseneve lumore përcaktohen nga KKU dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Seksioni 2
Dokumentet e planifikimit për menaxhimin e ujërave

Neni 15
Politikat

1. Politikat janë niveli më i lartë i planifikimit të menaxhimit të ujërave.
2. Dokumentet e politikave përmbajnë:
 - a) qëllimin e planifikimit dhe të zhvillimit të menaxhimit të burimeve ujore në harmoni me zhvillimin ekonomik, demografik, social, mjedisor, kulturor dhe historik;
 - b) masat e zbatimit;
 - c) planin operativ dhe buxhetin e nevojshëm e të përshtatshëm për zbatimin e tij.

Neni 16
Strategjia Kombëtare e Ujërave

1. Strategjia Kombëtare e Ujërave është një dokument planifikimi që përcakton vizionin e politikave të shtetit, misionin, qëllimet dhe objektivat në fushën e menaxhimit të integruar të ujërave për një periudhë afatgjatë.
2. Strategjia Kombëtare e Ujërave bazohet në kërkimet shkencore, vëzhgimin e vazhdueshëm të situatës dhe fenomenet që kanë lidhje me ujin dhe përdorimin e tij, duke respektuar problemet specifike të ujit dhe mbrojtjen e integruar të mjedisit në çdo rreth baseni lumor.
3. Strategjia Kombëtare e Ujërave është dokumenti kuadër për menaxhimin e ujërave për zhvillimin e planeve dhe dokumenteve të tjera strategjike në fushën e planifikimit territorial, mbrojtjes së mjedisit, diversitetit biologjik dhe peizazhit, bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, transportit, turizmit, shëndetit publik si dhe dokumenteve të tjera përkatëse.

4. Strategjia Kombëtare e Ujërave rishikohet çdo 15 vjet. Strategjia mund të rishikohet dhe të përditësohet edhe para përfundimit të këtij afati, nëse një gjë e tillë diktohet nga ndryshimet në sistemin e ujërave dhe zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit.
5. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Ujërave.
6. Organet, entet, institucionet e specializuara në fushën e ujërave, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Sekretariatit teknik hartojnë Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të ujërave.
7. Këshilli i Ministrave miraton përfundimisht Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit, pas miratimit nga KKKU.

Neni 17

Planet e menaxhimit të baseneve lumore

1. Planet e menaxhimit të baseneve lumore hartohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Ujërave të miratuar dhe zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar.
2. STKKU harton Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore dhe ja kalon për shqyrtim e miratim KKKU-së.
3. Këshilli i Ministrave, me propozim të KKKU, miraton Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore.
4. Planet e menaxhimit të baseneve lumore mbulojnë periudhën deri në vitin 2015 dhe më pas rishikohen çdo gjashtë vjet.

Neni 18

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Këshilli i Ministrave me propozimin e KKKU emëron një komision të posaçëm, që ngarkohet me administrimin e ujërave kufitare, administrimin e marrëdhënieve me shtetet kufitare për këto ujëra, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare.

Neni 19

Programe plotësuese

1. Plani i menaxhimit të rrethit/ rretheve të basenit lumor mund të plotësohet me programe më të hollësishme dhe plane menaxhimi për nën-basenin, sektorin, çështjet ose llojin e ujit, për të trajtuar aspekte të veçanta të menaxhimit të ujit.
2. Ministri me propozim të KKKU miraton me akt nënligjor kushtet dhe elementët përbërës të programeve plotësuese.

Neni 20

Detajet e Strategjisë dhe të Planit

1. Këshilli i Ministrave miraton përmbajtjen e detajuar, procedurat e zhvillimit, pjesëmarrjen publike dhe të gjitha çështjet e tjera që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Ujërave dhe të Planit të Menaxhimit të Basenit.

2. Vendimi i referuar në pikën 1 përfshin:
 - a) Objektivat mjedisore siç janë referuar në nenin 21;
 - b) parametrat kimikë dhe ekologjikë për ujërat sipërfaqësore siç përcaktohet në këtë ligj;
 - c) parametrat kimikë dhe sasiorë (normat) për statusin e ujërave nëntokësore siç përcaktohet në këtë ligj;
 - d) kushtet për shpalljen e trupave ujore tepër të modifikuar siç janë referuar në nenin 23;
 - e) specifikimet teknike dhe metodat e standardizuara lidhur me programin e monitorimit siç përcaktohet në këtë ligj;
 - f) specifikimet teknike në lidhje me analizën e karakteristikave të rrethit të basenit lumor siç referohen në nenin 31;
 - g) përmbajtjen e programit të masave të referuar në nenin 32;
 - h) kushtet dhe masat përkatëse për planifikimin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet të referuara në nenin 53, 54;
 - i) çdo çështje tjetër që ka lidhje me zbatimin e planit të menaxhimit të rrethit të basenit lumor.

Seksioni 3 **Klasifikimi i Ujërave**

Neni 21 **Objektivat Mjedisore**

1. Objektivat mjedisore për trupat me ujëra sipërfaqësore, nëntokësore si dhe për zonat e mbrojtura vendosen me qëllim parandalimin e dëmtimit të trupave ujorë si dhe mbrojtjen, shtimin dhe rehabilitimin e të gjithë trupave ujorë, si sipërfaqësore dhe nëntokësore.
2. Objektivat mjedisore të përcaktuara në pikën 1 përcaktohen duke marrë në konsideratë statusin e tyre kimik dhe/ose ekologjik, dhe/ose sasior.
3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton kriteret për vendosjen e objektivave mjedisore.

Neni 22 **Klasifikimi i ujërave**

1. Ujërat sipërfaqësore, me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e statusit të ujit, klasifikohen sipas statusit të tyre kimik dhe ekologjik.
2. Këto trupa ujorë, me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujërave nëntokësore, klasifikohen sipas statusit sasior dhe statusit kimik të tyre.
3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit përcakton ujërat sipas klasifikimit të tyre. Ministri, me propozim të Këshillit të Basenit Lumor dhe institucioneve të specializuara shkencore që mbulojnë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, në përputhje me parashikimet e këtij neni, shpall trupat ujorë dhe i publikon në Fletoren Zyrtare.

4. Trupat ujorë në bazë të klasifikimit të ujërave të tyre janë pjesë integrale e Planit të Menaxhimit të Basenit Lumor.

Neni 23

Trupat ujorë tepër të modifikuar

1. Ministri, me propozim të Këshillit të Baseneve të Lumenjve dhe në përputhje me përcaktimet e këtij ligji ka të drejtë:
 - a) të shpallë trupa të caktuar ujorë si artificialë ose tepër të modifikuar, kur objektivat mjedisore në lidhje me statusin e mirë apo potencialin e mirë ekologjik të tyre nuk mund të arrihen për shkak të pamundësisë teknike ose kostove tepër të larta;
 - b) të zgjasë afatet për arritjen e objektivave mjedisore me kusht që të mos ndodhë asnjë përkeqësim i mëtejshëm në statusin e trupit ujor të prekur;
 - c) të vendosë objektiva mjedisore më pak shtrënguese për trupa ujorë specifikët caktuar, kur ata janë shume të prekur nga aktiviteti njerëzor, apo kur kushtet e tyre natyrore janë të tilla që e bëjnë arritjen e këtyre objektivave të porealizueshme ose tepër të kushtueshme.
2. Ministri, me propozim të Këshillit të Basenit Lumor, përcakton masa të përshtatshme për parandalimin e përkeqësimit të statusit të trupit që është shpallur si trup ujor tepër i modifikuar.
3. Çdo shpallje e bërë sipas këtij neni dhe arsyet përkatëse përcaktohen në Planin e Menaxhimit të Basenit Lumor përkatës.
4. Shpalljet e bëra në përputhje me këtë nen rishikohen çdo 6 vjet.

KREU 4

KONTROLLI I NDOTJES

Seksioni 1

Normat e ujit

Neni 24

Normat e cilësisë së mjedisit për ujerat

1. Normat e cilësisë së mjedisit për ujerat përcaktohen në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” me qëllim parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së ujit.
2. Normat e cilësisë së mjedisit për ujerat përcaktohen për të gjitha ujerat, përfshirë ujerat nëntokësore.
3. Normat e cilësisë së mjedisit për ujerat përcaktohen për të gjitha burimet ujore, apo duke iu referuar:
 - a) përdorimit aktual ose potencial, të cilit i nënshtrohen cdo trup ujor i caktuar;
 - b) aktiviteteve që kryhen apo janë duke u kryer në trupa të tillë ujorë;
 - c) atyre trupave ujorë që, për të qënë në gjendje të mbështesin disa veprimtari të caktuara, kërkojnë mbrojtje.
4. KKKU ka të drejtë të kërkojë nga çdo Këshill Baseni identifikimin e trupave ujorë përkatës që kanë nevojë për mbrojtje.

5. KKKU identifikon trupat ujorë të referuar në pikën 4 sipas procedurës dhe në afatet kohore të përcaktuara prej tij.

Neni 25

Normat teknike të shkarkimit të ujërave në mjedis

Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton normat teknike të shkarkimit në mjedis për ujin, për substancat e rrezikshme, për substancat dhe parametrat e tjerë në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” me qëllim parandalimin e përkeqësimit të cilësisë së ujit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Neni 26

Cilësia e ujit të pijshëm

1. STKKU në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Shëndetësinë dhe Ministrinë përgjegjëse për Mjedisin, përcakton normat shtetërore të cilësisë së ujit që destinohet për konsum njerëzor.
2. Cdo operator që shfrytëzon një pike ujore duhet të pajiset me pasaportën teknike të kësaj pike pranë zyrave të patentimit në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.
3. Çdo person fizik a juridik, publik apo privat, që ofron ose shet në publik ujë të pijshëm ose ujë për përpunimin e ushqimeve, detyrohet të jetë i pajisur me leje, autorizime apo licenca përkatëse si dhe të përmbushë kërkesat e përcaktuara për normat shtetërore të cilësisë së ujit që destinohet për konsum njerëzor.
4. Njësitë e qeverisjes vendore dhe çdo institucion tjetër publik a privat, që kanë sistemin e tyre të furnizimit me ujë, detyrohen të marrin masa për një kontroll të rregullt të cilësisë së ujit të shpërndarë. Inspektoriati përkatës urdhëron ndërprerjen e shpërndarjes së ujit nëse ai nuk plotëson normat e cilësisë.

Seksioni 2

Kontrolli i ndotjes

Neni 27

Përqasja e kombinuar

1. Kontrolli i ndotjes bazohet në parimin e përqasjes së kombinuar dhe synon parandalimin e përkeqësimit dhe mbrojtjen, shtimin dhe kthimin në gjendje të pranueshme të trupave me ujë sipërfaqësore.
2. Kontrolli i ndotjes realizohet nëpërmjet zbatimit të vlerave përkatëse kufi të shkarkimeve, bazuar në teknikat më të mira të disponueshme apo dhe në praktikatat më të mira mjedisore kur ndikimet janë të shpërndara.
3. Kontrole më të plota e më të detajuara për shkarkimet kryhen sipas rastit kur një objektiv mjedisor ose normë mjedisore e cilësisë së ujit kërkon kushte më strikte sesa ato të parashikuara në pikën 1.

Neni 28

Lejet e Mjedisit

1. Çdo person fizik ose juridik që ushtron një aktivitet që shkarkon ujëra të ndotur në trupat ujqorë duhet të ketë lejen përkatëse të mjedisit, në përputhje me kushtet e kërkesat e Ligjit "Për Lejet e Mjedisit".
2. Leja e mjedisit e personave fizike ose juridike, veprimtaritë e te cilëve gjenerojnë ujëra të ndotura, përmban:
 - a) kushtet e veçanta për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta në përputhje me llojin e veprimtarisë;
 - b) kërkesat për ndërtimin dhe funksionimin e rrjetit te brendshëm të kanalizimeve;
 - c) kërkesat për trajtimin fillestar të ujerave të përdorura;
 - ç) masat për parandalimin e ndotjes së mjedisit prej tyre;
 - d) kolektorin ku duhet të shkarkohen ujërat e përpunuara dhe regjimin e shkarkimit të tyre;
 - dh) detyrimin për mbajtjen e regjistrave;
 - e) detyrimin për kryerjen e vetë-monitorimit dhe publikimit të rezultateve të tij.
3. Personat fizike dhe juridike qe ndërmarrin largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura pajisen me lejen përkatëse të mjedisit, që përcakton:
 - a) kërkesat dhe kushtet e vendit të ndërtimit të impianteve dhe instalimeve për përpunimin e ujërave;
 - b) llojin e impiantit ose impianteve që do të përdorin;
 - c) metodat, teknikat dhe teknologjitë që përdor impianti dhe rregullat për operimin e tij;
 - ç) normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta, që duhet të plotësojnë ujërat pas trajtimit;
 - d) mjedisin pritës ku do të derdhen ujërat e trajtuara dhe regjimin e shkarkimit të tyre;
 - dh) kërkesat për trajtimin mjedisor te llumrave që rezultojnë nga trajtimi i ujërave të ndotura, në përputhje me natyrën, përbërjen dhe sasinë e tyre;
 - e) detyrimin për mbajtjen e regjistrave;
 - f) detyrimin për kryerjen e vetë-monitorimit dhe publikimin e rezultateve të tij.

Neni 29

Zonat e mbrojtura

1. Zonat e mbrojtura, në bazë të këtij Ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, përcaktohen me qëllim mbrojtjen e ujërave dhe ekosistemeve ujore dhe përfshijnë masa të veçanta mbrojtëse.
2. Zonat e mbrojtura përfshijnë:
 - a) zonat higjieno-sanitare të mbrojtura për ujë të pijshëm;
 - b) zonat për peshkim dhe rritjen e butakëve sipas legjisllacionit per peshkimin;
 - c) zonat për banja dhe rekreacion;
 - d) zonat e prirura ndaj eutrifikimit dhe zonat në rrezik nga nitratet;
 - e) zonat e synuara për mbrojtjen e njerëzve, bimëve apo kafshëve, si dhe të habitateve ku ruajtja apo përmirësimi i statusit të ujit është një element i rëndësishëm i mbrojtjes së tyre.

3. Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit shpall zonat e mbrojtura të përcaktuara në pikën 2 dhe i publikon në Fletoren Zyrtare.
4. Në zonat e mbrojtura të synuara për mbrojtjen e njerëzve, bimëve, kafshëve, apo habitateve ku ruajtja apo përmirësimi i statusit të ujit është një element i rëndësishëm i mbrojtjes së tyre, zbatohen masat e parashikuara sipas legjislacionit për mbrojtjen e natyrës, nëse nuk përcaktohet ndryshe nga ky ligj.
5. Këshillat e Baseneve Lumore dhe Ministria hartojnë dhe menaxhojnë inventarin e zonave të mbrojtura si pjesë integrale e planit të menaxhimit të zonave të mbrojtura.
6. Planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur përfshihet në Planin e Menaxhimit të Basenit lumor përkatës.
7. Inventarët e zonave të mbrojtura përditësohen rregullisht.

Neni 30

Mbrojtja e zonave të prirura ndaj ndotjes

1. Ministri harton aktet përkatëse nënligjore për shpalljen e zonave në rrezik nga ndotja prej elementëve apo substancave të dëmshme si nitratat, fosfatet, produktet për mbrojtjen e bimëve, biocidet, dhe i paraqet për miratim në KKU.
2. Ministri, në bashkëpunim me Ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe Ministrin përgjegjës për Ekonominë, nxjerr rregullore që përcaktojnë programet, masat dhe detyrimet e tjera përkatëse me qëllim reduktimin dhe parandalimin e ndotjes së ujërave nga substancat e dëmshme si ato të cituara në pikën 1 të këtij neni, ashtu edhe ato që shkaktohen apo rrjedhin nga veprimtari të tjera bujqësore.
3. Përqasja e kombinuar, siç përcaktohet në Nenin 27, zbatohet për shkarkimet nga pikat dhe burimet shpërndarëse në zonat e përcaktuara në pikën 1.

Seksioni 3

Masat për mbrojtjen e ujit

Neni 31

Karakteristikat e Baseneve Lumore

1. Këshilli i Basenit Lumor kryen për çdo basen dhe rrethin e basenit lumor përkatës analizat e karakteristikave të tij, vlerësimin e ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe analizën ekonomike të përdorimit të ujërave.
2. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, përcakton me akt nënligjor specifikimet teknike të nevojshme për kryerjen e analizave dhe rishikimeve siç përcaktohet në pikën 1.
3. Analizat dhe vlerësimet e përcaktuara në këtë nen do të kryhen në vitin 2015 dhe çdo 6 vjet pas kësaj date do të rishikohen dhe, nëse është e nevojshme, do të përditësohen.

Neni 32
Programet e masave

1. Këshilli i Basenit lumor, me qëllim arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara në Nenin 21, harton programin e masave për basenin/ rrethin e basenit lumor duke marrë në konsideratë rezultatet e analizave sic përcaktohet në Nenin 31.
2. Ministri, me akt nënligjor, miraton programin e masave të hartuar nga cdo Këshill Baseni Lumor.
3. Programi i masave për rrethin e çdo baseni lumor përfshin periudhën deri në vitin 2015 dhe më pas rishikohet çdo 5 vjet dhe nqse është e nevojshme përditësohet.
4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë, miraton përmbajtjen e programit të masave sipas parashikimeve të këtij neni.

KREU 5

LIÇENCAT, AUTORIZIMET, LEJET DHE KONÇESIONET
PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE UJORE

Neni 33

Autoritetet që lëshojnë liçenca, autorizime, leje dhe japin konçesione

1. Autoritetet e ujërave japin liçenca, autorizime, leje dhe lidhin kontrata konçesioni për përdorimin e ujërave duke u bazuar në parimet e proporcionalitetit, deburokratizimit, pakësimit të barrierave administrative dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij Kreu të ligjit.
2. Këshilli i Basenit lëshon liçencat, autorizimet dhe lejet në rastet kur aktiviteti do të kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe brenda kufijve të një baseni të vetëm.
3. Këshilli Kombëtar i Ujërave lëshon liçencat, autorizimet dhe lejet në rastet kur aktiviteti do të kryhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë por në një zonë që i kalon kufijtë e një baseni të vetëm..
4. Këshilli Kombëtar i Ujërave dhe Këshillat e Baseneve japin konçesione në bazë të klasifikimit të burimeve ujore dhe sipas procedurave, kritereve dhe kushteve të përcaktuara me akte ligjore e në nligjore.
5. Liçencat, autorizimet, lejet, dhe konçesionet për përdorimin e ujërave:
 - a) janë personale dhe i takojnë “Titullarit të Liçencës, Autorizimit/ Lejes/ Konçesionit” përkatës;
 - b) nuk mund të transferohen pa miratimin e autoriteteve lëshuese përkatëse të ujërave;
 - c) janë të vlefshme për një afat të caktuar dhe rinovohen sipas një procedurë të përcaktuar;
 - d) mund të ndryshohen, të refuzohen ose të anulohen në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
 - e) lëshohen pas pagimit të një tarife për shpenzimet administrative;
 - f) regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Liçencave dhe Lejeve sipas parashikimeve ligjore e nënligjore përkatëse;

- g) nuk mund të refuzohen, revokohen apo anulohen/shfuqizohen pa një vendim të arsyetuar të organit administrativ që shqyrton kërkesën për liçencë, autorizim, apo leje;
6. Këshilli i Ministrave, në zbatim të këtij ligji dhe ligjit për liçencat, autorizimet dhe lejet përcakton:
- a) kushtet e posaçme të liçencimit, të autorizimit dhe lejimit dhe dokumentet shoqëruese të nevojshme që paraqiten për këtë qëllim;
 - b) afatin e vlefshmërisë së liçencës, të autorizimit dhe lejes;
 - c) procedurat dhe afatet e shqyrtimit dhe të vendim-marrjes administrative, si dhe
 - d) procedurat e revokimit nga organet administrative.

Neni 34

Parimet e përgjithshme për dhënien e liçencave, autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve

1. Liçenca, autorizimi, leja ose koncesioni lëshohet vetëm nqse:
- a) aktiviteti i personit fizik apo juridik që është titullar i liçenses, autorizimit, lejes apo koncesionit nuk ndikon negativisht në përdorimin e ujërave;
 - b) është në përputhje me Planin e Menaxhimit të Basenit lumor përkatës;
 - c) nuk çon në shkeljen e normave të cilësisë së ujit të mjedisit të përcaktuara në këtë ligj;
 - d) nuk çon në cenimin e objektivave mjedisore përkatëes të përcaktuara në këtë ligj;
 - e) nuk bie ndesh me programin e masave të parashikuar në bazë të këtij ligji.

Neni 35

Kushtet e përgjithshme të liçencave, autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve për përdorimin e ujërave

1. Liçenca, autorizimi, leja apo kontrata koncesionare për përdorimin e ujërave përmban të paktën këto të dhëna të përgjithshme:
- a) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;
 - b) të dhënat për identifikimin e titullarit;
 - c) llojin e veprimtarisë që lejohet dhe qëllimin, për të cilin do të përdoret uji;
 - d) sasinë e ujit që mund të përdoret duke iu referuar ose një vëllimi fiks ose një pjese të rrjedhës;
 - e) vëllimin e rrjedhës së kthyer, nqse ka, dhe vendin ku rrjedha e kthyer do të shkarkohet;
 - f) sipërfaqen e tokës me të cilën lidhet përdorimi i ujit, në rastet kur uji do të përdoret për vaditje;
 - g) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nqse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për atë kategori/nënkategori);
 - h) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimit apo në përdorimin e të mirës publike;
 - i) periudhën e vlefshmërisë së liçencës, autorizimit, lejes apo koncesionit;

2. Liçenca, autorizimi, leja apo kontrata koncesionare përmban detyrimisht kushtet e përgjithshme si më poshtë që e detyrojnë operatorin:
 - a) të përdorë ujërat në mënyrë racionale duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
 - b) të përdorë ujërat vetëm për qëllimet për të cilat i është dhënë liçenca, autorizimi, leja apo kontrata koncesionare;
 - c) të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
 - d) të instalojë ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti përkatës që ka lëshuar lejen apo ka dhënë koncesionin;
 - e) të regjistrojë vëllimin e ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer;
 - f) të japë të dhëna dhe informacion mbi përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga autoritetet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore.
3. Kushtet e posacme, dokumentet shoqëruese, afati i vlefshmërisë, procedurat e shqyrtimit dhe vendim-marrja përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Licenca dhe leja e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura hyn në fuqi vetëm pas publikimit të saj në Regjistrin e Licencave dhe Lejeve, përveç rastit kur hyrja në fuqi e aktit që e miraton atë lidhet me botimin në Fletoren zyrtare.
5. Lejet e përdorimit të ujit përfshihen në kategorinë III.6 të shtojcës së Ligjit nr 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 36

Pezullimi dhe ndryshimi i përkohshëm i kushteve të liçencave, autorizimeve, lejeve apo koncesioneve

1. Liçenca, autorizimi, leja dhe koncesioni mund të pezullohen, të ndryshohen ose të revokohen kur titullari përkatës nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.
2. Pezullimi dhe ndryshimi i kushteve që përmbahen në liçencat, autorizimet, lejet dhe koncesionet kryhet me miratimin e autoritetit lëshues:
 - a) si pasojë e një urdhri për thatësinë të lëshuar në bazë të këtij ligji;
 - b) kur kanë ndodhur ndryshime për shkak të forcave madhore;
 - c) me kërkesë të mbajtësit të titullit;
 - d) në rast të mos-respektimit nga titullari të kushteve të liçencës, autorizimit, lejes ose koncesionit.

Neni 37

Anullimi ose revokimi i liçencave, autorizimeve, lejeve dhe koncesioneve

1. Liçencat, autorizimet, lejet dhe koncesionet mund të anulohen, ose revokohen:
 - a) Kur, bazuar në interesin publik dhe në përputhje me Planin e Menaxhimit të Baseneve të Lumenjve, është i nevojshëm përdorimi i ujërave për një qëllim tjetër;
 - b) titullari i licencës/ autorizimit/ lejes/ koncesionit nuk respekton kushtet përkatëse edhe pas pezullimit të lejes/autorizimit për një afat të caktuar;

- c) me kërkesën e titullarit të licencës/ autorizimit/ lejes/ koncesionit/;
 - d) nëqse ujërat, me të cilat lidhet leja, autorizimi ose koncesioni nuk janë përdorur për një periudhë prej tre vjetësh;
 - e) me vdekjen e titullarit si person fizik apo me mbarimin e titullarit të licencës/autorizimit/lejes/ koncesionarit si person juridik.
2. Çdo vendim i autoritetit të ujit për anulimin apo revokimin e një licënce, autorizimi, leje, apo koncesioni mund të apelohej në rrugë administrative tek Ministri sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Akti administrativ që nxjerr Ministri për anulimin ose revokimin e tyre ankimohej në rrugë gjyqësore sipas afateve dhe procedurave ligjore për kundërvajtjet administrative.

Neni 38

Përdorimi i materialeve inerte

Autoritetet e ujit lëshojnë autorizim për shfrytëzimin e materialeve inerte si rërë, zhavorr, etj. që nxirren nga shtretërit dhe brigjet e lumenjve, përrenjve, liqeneve, etj. me ose pa ujë, vetëm nëqse plotësohen kriteret dhe kërkesat ligjore të përcaktuara.

Neni 39

Shpuesit profesionistë

1. Shpuesi profesionist për ujë, që e ushtron veprimtarinë në baza tregtare, duhet të jetë i pajisur me licencën e parashikuar në kategorinë III. 7, të shtojcës së ligjit për licencat. Kjo veprimtari licençohet sipas ligjit për licencat.
2. Shpuesi profesionist, jo më vonë se dy muaj pas përfundimit të shpimit, i paraqet autoriteteve të ujit, si dhe Sherbimit Gjeologjik Shqiptar një raport të detajuar hidrogeologjik në lidhje me shpimin, me mostrat e shtresave të shpuara, si dhe gjithë dokumentacionin përkatës.

KREU 6

ZONAT DHE SIPERFAQET E MBROJTURA

Neni 40

Zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare

1. Zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare përcaktohen rrotull burimeve sipërfaqësore ose nëntokësore të ujit që furnizojnë popullsinë urbane e rurale me ujë të pijshëm me qëllim që të ruhet cilësia e ujit pranë burimit.
2. Kufijtë e këtyre zonave përcaktohen sipas rregulloreve të hartuara nga STKKU me institucionet përkatëse të shëndetësisë.
3. Zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare përbëhen nga:
 - a) Zona e parë e mbrojtjes rrotull burimit, që kontrollohet nga operatori që nxjerr, prodhon dhe shpërndan ujë të pijshëm. Kjo zonë rrethohet;
 - b) Zona e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës ndalohen ndërtimet, zhvillimi i industrisë, kryerja e veprimtarive bujqësore e blegtorale, hapja e puseve, hapja e

- kanaleve, depozitimi apo shkarkimi i ndotjeve, i ujërave të zeza, i substancave kimike e toksike, përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve, përdorimi si varrezë apo groposja e kafshëve të ngordhura;
- c) Zona e mbrojtjes së largët.
4. Personat fizikë dhe juridikë, interesat e të cilëve dëmtohen nga përcaktimi i zonave të mbrojtjes, kompensohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 41

Zonat e mbrojtjes emergjente

1. Autoritetet e ujit mund të përcaktojnë dhe të krijojnë zona ose sipërfaqe të mbrojtura sa herë që burimet sipërfaqësore ose nëntokësore rrezikohen seriozisht në sasi e cilësi, kur ka konflikte mes përdoruesve të ujit, ose kur ekziston rreziku i përhapjes së sëmundjeve.
2. Regjimi i këtyre zonave ose sipërfaqeve, si dhe kufizimet e tyre, vendosen dhe ndryshojnë sipas rrethanave.

Neni 42

Zona me mbrojtje të veçantë

1. KKU, me propozim të Këshillit të Basenit, miraton si zona vecanërisht të mbrojtura, zona të caktuara, basene, pjesë basenesh, rrjedha ujore, lumenj, etj. që kanë tipare natyrore të veçanta apo që kanë interes ekologjik.

Neni 43

Bashkërendimi i planeve të rregullimit të territorit me ato të burimeve ujore

Autoritetet që hartojnë planet dhe studimet e rregullimit të territorit marrin në konsideratë planet e menaxhimit të burimeve ujore të hartuara nga KKU.

Neni 44

Tokat e mbuluara me ujë

1. Kënetat ose sipërfaqet e mbuluara me ujë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj përfshirë edhe ato që janë krijuar artificialisht, quhen toka të mbuluara me ujë. KKU përcakton kufijtë e tyre.
2. Të gjitha veprimtaritë që kryhen ose ndikojnë mbi to janë objekt i liçencave, autorizimeve, lejeve dhe konçesioneve.

Neni 45

Zonat e rrezikshme për shëndetin

KKU, në bashkëpunim me organet përkatëse shëndetësore dhe ato të mbrojtjes së mjedisit, përcakton zonat e rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve, që janë shpallur si të dëmshme për interesat publike dhe vendos tharjen e tokave që janë nën ujë.

KREU 7 MBROJTJA E BRIGJEVE

Neni 46 Mbrojtja e përkohshme

Persona fizike a juridikë, publikë dhe privatë pas marrjes së miratimit nga autoritetet e ujit mund të kryejnë veprimtari mbrojtëse të përkohshme në raste emergjence.

Neni 47 Mbrojtja e brigjeve

Mbrojtja e brigjeve është detyrë publike. Ajo realizohet me anë të ndërtimeve, rindërtimeve dhe mirëmbajtjes së pritave, veprave veshëse dhe veprave e masave të tjera teknike, ku përfshihen edhe ato biologjike.

Neni 48 Veprimtaritë ndërtimore në brigje

Organet përgjegjëse të rregullimit e planifikimit të territorit lëshojnë leje për ndërtimin, rindërtimin apo shembjen e objekteve mbrojtëse të brigjeve, mureve, portave e vepra të tjera në brigje, si: ura, shkallë, gardhe, linja kabllorësh ose tubash, ndërtesa mbi kolona, hendeqe ose rrugë, pasi marrin miratimin nga autoritetet e ujit..

Neni 49 Veprimtari të ndaluara në brigje dhe plazhe

1. Në brigje, plazhe dhe ne zonat e vershimit ndalohet:
 - a) ndryshimi a zhvendosja e mbulesës bimore natyrale apo artificiale;
 - b) marrja e materialeve inerte (rërë, zhavorr, gurë, etj.) ose plisa;
 - c) ndërtimi i vendeve të parkimit për mjete ujore dhe automjete tokësore;
 - d) krijimi i vendeve të thata për rrjetat;
 - e) gjermimi, shpimi ose shpëlarjet.
 - f) hedhja apo depozitimi i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore, gjermimeve të ndryshme, apo që janë pasoje e cdo veprimtarie tjetër që gjeneron materiale inerte.

2. Autoritetet e ujit në bashkëpunim me organet përgjegjëse të rregullimit e planifikimit të territorit, me qëllim sigurimin dhe mirëmbajtjen e bregut, kanë të drejtë të kufizojnë ose ndalojnë shfrytëzimin e plazhit, të fundit të detit, të dunave, të brigjeve të pjerrëta dhe të çdo sipërfaqeje tjetër që është përcaktuar për mbrojtjen e bregut dhe mirëmbajtjen e tij.

KREU 8 SERVITUTET

Neni 50 Servitutet

1. Pronarët e tokave, për çështjet e servituteve që lidhen me rrjedhjen e ujërave dhe marrjen e ujërave, i referohen përcaktimeve të bëra në dispozitat e Kodit Civil.
2. Mosmarrëveshjet që lindin për servitutet, kur nuk zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, janë kompetencë e gjyqësorit.

Neni 51 Veprimtaritë në brigje

Në tokat pronë private dhe shtetërore përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet detyrimisht të lihet:

- a) Një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi prej 5 deri 100 metrash nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve, ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë këtë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të KKU.
- b) Një sipërfaqe toke e lirë për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga KKU, me gjerësi 100 m deri 200 m.

Neni 52 Të drejtat e pronarëve të tokave fqinje

Pronari i tokës ku është caktuar servituti mund të kërkojë të marrë pjesë në ndërtimin e veprave ujore në atë tokë. Në këtë rast ai do të përballojë:

- a) një pjesë të shpenzimeve të ndërtimit të veprës, nga e cila ai përfiton;
- b) shpenzimet për modifikimet që mund të bëhen të nevojshme nga ushtrimi i të drejtës së servitutit;
- c) një pjesë të shpenzimeve për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e veprave.

KREU 9

EFEKTET E DËMSHME TË UJIT

Neni 53

Permbytjet

1. Autoritetet e ujit, për të garantuar sigurinë e njerëzve dhe të pronave, marrin masat e nevojshme brenda sipërfaqeve që preken nga përmbytjet. Në rast përmbytjesh të mëdha ato në bashkëpunim me strukturat dhe organet përgjegjëse për emergjencat civile urdhërojnë ekzekutimin e punimeve të emergjencës duke kërkuar nga përdoruesit e ujit të gjitha pajisjet dhe materialet e nevojshme për këtë qëllim.
2. Autoritetet e ujit në bashkëpunim me strukturat dhe organet e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për parandalimin, përbalimin dhe për rehabilitimin e gjendjes së shkaktuar.
3. Çdo person fizik a juridik detyrohet të bashkëpunojë me autoritetet përgjegjëse të përcaktuara në këtë nen për eliminimin e pasojave të përmbytjeve dhe efekteve të tjera të dëmshme të ujit.

Neni 54

Tokat e përmbytura

1. Tokat që mund të përmbyten gjatë daljes nga shtrati i zakonshëm i liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lumenjve, përrenjve e rrjedhave të tjera ruajnë statusin e tyre të mëparshëm ligjor.
2. KKU, pas marrjes së mendimit nga strukturat drejtuese lokale si dhe nga strukturat dhe organet përgjegjëse për emergjencat civile, në raste të veçanta vendos kufizime për përdorimin e zonave të përmbytura ose të zonave që janë nën efektet e dëmshme të ujit, kur këto rrezikojnë jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë, apo pronën publike e private.
3. Magazinimi i materialeve dhe lëndëve që mund të shpëlahen në ujë dhe ndërtimi i objekteve të reja në zonat e kërcënuara nga përmbytjet është i ndaluar.

KREU 10

VEPRAT DHE OBJEKTET UJORE

Neni 55

Ndërtimi

1. Ndërtimi i veprave dhe objekteve për shfrytëzimin e burimeve ujore dhe parandalimin e veprimeve të dëmshme të ujit që bëhen për shërbime publike është objekt i licencave, autorizimeve, lejeve, ose koncesioneve.
2. Personi fizik a juridik, përgjegjës për ndërtimin, brenda 15 ditëve nga përfundimi i veprës a objektit duhet të njoftojë autoritetet e ujit që kanë lejuar kryerjen e veprimtarisë që të kryejnë inspektimin përfundimtar në këtë vepër a objekt ujor.

Neni 56
Kompetencat e autoritetit të ujit

1. Autoriteti i ujit në bashkëpunim me Inspektoratin e Mjedisit, *Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar* dhe organet e qeverisjes vendore ka të drejtë të mbikëqyrë e detyrojë subjektet, persona fizike apo juridike për instalimin e pajisjeve për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e ujit në tokë private, si dhe të servituteve që nevojiten për hyrjen në instalime të tilla, për punën përgatitore dhe për ndërtimin.
2. Autoriteti i ujit në bashkëpunim me Inspektoratin e Mjedisit dhe *Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar* ka të drejtë të kontrollojë vënien në punë në afatet e përcaktuara në leje dhe mirëmbajtjen e objekteve të veprave hidroteknike, si dhe të vendosë sanksione e të detyrojë vendosjen e tubacioneve të transportit të ujit të pijshëm ose atij të kanalizimeve.
3. Autoriteti i ujit në bashkëpunim me Inspektoratin e Mjedisit dhe *Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar* kryen kontrole periodike të punimeve dhe objekteve ujore. Për këtë qëllim personat e autorizuar prej tyre kanë të drejtë të inspektojnë veprat dhe objektet dhe të kërkojnë të dhëna e dokumentacionin lidhur me to.

KREU 11
SHKARKIMET DHE KANALIZIMET

Neni 57
Shkarkimet e lëngëshme

1. Shkarkimet në ujë, tokë, nëntokë a në gropa, bëhen në përputhje me parashikimet ligjore e nenligjore.
2. Këshilli Kombëtar i Ujit, Ministri përgjegjës për mjedisin dhe Ministri përgjegjës për shëndetësinë, me akt nënligjor përcaktojnë norma dhe kërkesa të përgjithshme e specifike për lloje të ndryshme të veprimtarive që kryejnë shkarkime të lëngëshme në mjedis.
3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, Ministrit përgjegjës për rregullimin e territorit dhe Ministrit përgjegjës për shëndetësinë, miraton kriteret mjedisore për ndërtimin dhe të funksionimin e sistemeve të kanalizimeve.
4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëshme.

Neni 58
Sistemi i kanalizimeve

Të gjitha veprimtaritë që gjenerojnë ujëra të ndotura detyrohen të lidhen dhe të përdorin kanalizimet e ujërave të ndotura, me përjashtim të zonave rezidente ku nuk ka sistem publik kanalizimesh, në të cilat lejohet sistemi i trajtimit të ujërave të ndotura individuale, në përputhje me legjislacionin që rregullon shërbimet e ujësjellës kanalizimeve dhe aktet e tjera nënligjore që zbatohen në këtë sektor.

KREU 12 **PËRDORIMI I UJËRAVE**

Neni 59 **Qëllimet e përdorimit të ujit**

Uji përdoret për qëllimet e mëposhtme:

- a) shtëpiake, komunale, bujqësore (përfshirë ujitjen dhe ujin për blegtorinë);
- b) akuakulturë, transport ujqor, industrial, prodhim hidroenergjetik;
- c) tregti, turizëm, argëtim (përfshirë lundrimin për argëtim);
- d) qëllime të tjera të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujërave.

Neni 60 **Përdorimi i burimeve ujore**

1. Ndalohet përdorimi i ujit pa liçencë, autorizim, leje apo kontratë konçesionare të lëshuar nga autoritetet e ujërave, përveçse në rastet e përcaktuar në këtë ligj.
2. Përdorimi i burimeve ujore natyrore i nënshtrohet kontrollit administrativ nga autoritetet e ujërave dhe inspektimit nga organet inspektuese.

Neni 61 **Përdorimi i lirë i ujit**

1. Kushdo ka të drejtë të përdorë lirisht burimet ujore sipërfaqësore për të pirë dhe për nevoja të tjera shtëpiake e të blegtorisë, pa tejkaluar nevojat, sasi të e nevojshme për plotësimin e nevojave individuale dhe familjare të përdoruesit dhe në përputhje me ligjet dhe planet përkatëse të këshillave të baseneve.
2. Kushdo ka të drejtë të përdorë lirisht ujërat e brigjeve për t'u larë dhe për sporte ujore.
3. Kushdo ka të drejtë të përdorë ujin e shiut që bie në tokë private, me kusht që ky ujë të mos jetë mbledhur në instalime artificiale.
4. Autoritetet e ujit kanë të drejtë që gjatë periudhave të mungesës të ujit, apo kur cilësia e ujit është dëmtuar, kur përhapen ose ka rrezik të përhapen sëmundje të shkaktuara nga uji, të kufizojnë përdorimin e lirë të ujit në të gjithë vendin ose në zona të veçanta.

Neni 62 **Përdorimi i ujit me autorizim**

1. Veprimtaritë e mëposhtme mund të kryhen vetëm pas pajisjes me autorizim nga autoritetet e ujit:
 - a) përdorimi i ujit, kur realizohet nëpërmjet instalimeve të përhershme;
 - b) ujitja, përveç rasteve kur përdoruesi furnizohet me ujë sipas legjislacionit në fuqi;
 - c) dhënia e ujit bagëtive;
 - d) akuakultura;

- e) përdorimet industriale të ujit, duke përfshirë minierat;
 - f) shfrytëzimi i ujërave nëntokësore për qëllime të ndryshme, përfshirë përdorimin shtëpiak;
 - g) mbjellja e pemëve dhe e bimëve në brigjet e lumenjve dhe përrenjve kur ato pengojnë rrjedhjen natyrore të ujit;
 - h) nxjerrja e materialeve të ngurta nga brigjet dhe shtretërit e lumenjve, përrenjve dhe rezervuarëve me ose pa ujë;
 - i) përdorimi ose ri-përdorimi i ujërave të përdorura, duke përfshirë aplikimin e tyre në tokë.
2. Lundrimi dhe ndërtimi i strukturave ankoruese dhe portuale mund të kryhen vetëm me Autorizim nga Këshilli Kombëtar i Ujërave:
 3. Përdorimi i burimeve ujore për qëllime dhe aktivitete peshkimi përcaktohet me akte ligjore e nënligjore që rregullojnë këto veprimtari.
 4. Veprimtaritë e tjera që përdorin burime ujore janë subjekt i lejimeve përkatëse në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore.

Neni 63

Dhënia e koncesioneve për përdorimin e ujërave

1. Dhënia e koncesioneve për përdorimin e ujërave bëhet në përputhje me ligjin për koncesionet dhe aktet nënligjore që përcaktojnë kërkesa dhe procedura për dhënien e koncesioneve.
2. Autoriteti kontraktues i ujit mban regjistrin e koncesionit. Ky regjistër ruhet dhe administrohet nga autoriteti përkatës kontraktues për një periudhë kohe sipas kërkesave të ligjit për arkivat.

Neni 64

Detyrat e përdoruesve të ujit

Përdoruesit e ujit duhet:

- a) të përdorin ujin në mënyrë racionale dhe ekonomike;
- b) të respektojnë kushtet dhe detyrimet e vëna mbi të drejtën e përdorimit të ujit;
- c) të sigurojnë mbrojtjen e ujit nga ndotja, të mbajnë nën kontroll cilësinë e ujit dhe të mbrojnë mjedisin nga ndotësit e ndryshëm;
- d) të respektojnë të drejtat e përdoruesve të tjerë të ligjshëm të ujërave dhe të palëve të treta.

Neni 65

Thatësira dhe Mungesa e Ujit

1. Këshilli Kombëtar i Ujërave, me propozim të Ministrit, në kushtet e thatësirës apo të mungesës së ujit nxjerr akt nënligjor për marrjen e masave të nevojshme për thatësirën, i cili publikohet në Fletoren Zyrtare, dhe midis të tjerave përfshin :
 - a) kufizime në disa ose të gjitha veprimtaritë që përfshijnë përdorimin e burimeve ujore;

- b) kufizimin e përdorimit të ujit në përputhje me liçencat, autorizimet, lejet dhe koncesionet për përdorimin e ujit;
- c) Përcakton përparësitë e reja për përdorimin e ujërave brenda zonës që vuan nga thatësira apo mungesa e ujit.

Neni 66

Trupat ujqorë që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm

1. Këshilli i Basenit Lumor për çdo rreth të basenit lumor përkatës duhet të identifikojë në mënyrë të veçantë:
 - a) të gjitha trupat ujqorë nga ku nxirret ujë për konsum njerëzor që japin mesatarisht mbi 10 m³ në ditë dhe që furnizojnë më shumë se 50 njerëz;
 - b) të gjithë trupat ujqorë të destinuar për përdorime të tilla në të ardhmen.
2. Këshilli i Basenit lumor dhe autoritetet përkatëse të ujit duhet të sigurojnë mbrojtjen e ujërave të referuar në këtë nen me qëllim që të shmangin përkeqësimin e cilësisë së tyre dhe të reduktojnë nivelin e pastrimit të nevojshëm për përfitim të ujit të pijshëm.
3. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton zonat e mbrojtjes sanitare për ujërat e përcaktuar në këtë nen dhe dispozitat rregullatore për zbatimin e këtyre parashikimeve ligjore.

KREU 13

TRAJTIMI I UJËRAVE TË PËRDORUR

Neni 67

Impiantet e trajtimit të ujërave të përdorur

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit dhe të Ministrit përgjegjës për punët publike, miraton kërkesat për projektimin, ndërtimin dhe operimin e sistemeve grumbulluese dhe të impianteve të trajtimit të ujërave të përdorura.
2. Menaxhimi i llumrave të ujërave të zeza bëhet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave të parashikuar në nenin 35 të Ligjit nr. ... dt... "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

KREU 14

MENAXHIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET

Neni 68

Planifikimi i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet

1. Ministria ne bashkepunim me Ministrine përgjegjëse për Mbrojtjen Civile, harton akte nenligjore per planet dhe rregullat per menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, ne përputhje me Planin Kombetar te Emergjencave Civile.
2. Këshilli i Basenit lumor, harton për rrethet e basenit lumor të tij planin e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, i cili fokusohet në parandalimin, mbrojtjen, gadishmërinë,

përfshirë parashikimin e përmbytjeve dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe e paraqet për miratim në strukturat përgjegjëse për Mbrojtjen Civile.

3. Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet hartohet duke marrë në konsideratë karakteristikat përkatëse të baseneve lumore dhe/ose nën-baseneve. Planet e menaxhimit të përmbytjeve përfshijnë edhe promovimin e praktikave të përdorimit të qëndrueshëm të tokës, përmirësimin e aftësisë mbajtëse të ujit kontrollin nga përmbytjet të zonave të caktuara, në rast përmbytje
4. Plani i menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet është pjesë integrale e Planit të Menaxhimit të Basenit Lumor.

KREU 15 MONITORIMI

Neni 69

Monitorimi i statusit të ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe zonave të mbrojtura

1. Këshilli i Basenit lumor harton dhe zbaton programin e monitorimit të statusit të ujërave në mënyrë që të përcaktohet një rishikim koherent dhe i kuptueshëm i statusit të ujit, brenda secilit rreth të basenit lumor.
2. Për ujërat sipërfaqësore programe të tilla duhet të mbulojnë:
 - a. volumin dhe nivelin, ose shkallën e rrjedhjes që kërkohet për të arritur statusin përkatës ekologjik dhe kimik, potencialin ekologjik, dhe
 - b. statusin ekologjik dhe kimik dhe potencialin ekologjik;
3. Për ujërat tokësore keto programe duhet të mbulojnë monitorimin e statusit kimik dhe të statusit sasior.
4. Sipas rastit, programet e lartpërmendura do të plotësohen duke ju referuar edhe specifikimeve të dhëna në legjislacionin për zonat e mbrojtura.
5. Programi për ujërat nëntokësore duhet të mbulojë dhe trajtojë monitorimin e statusit kimik dhe sasior.
6. Këto programe do të vihen në zbatim jo më vonë se ----- me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në legjislacionin përkatës.
7. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton kërkesat për programet e monitorimit sipas këtij neni.
8. Zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 70

Monitorimi i trupave ujqorë që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm

1. Këshilli i Basenit lumor monitoron trupat ujqorë që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm nga ku nxirret mesatarisht më shumë se 100 m³.
2. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, përcakton dhe miraton kërkesat për programet e monitorimit sipas këtij neni.

Neni 71

Monitorimi dhe menaxhimi i të dhënave

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton Rregullore për hartimin e programit të monitorimit sistematik të kushteve të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore dhe të zonave të mbrojtura.
2. Rregullorja përcakton parametrat që do të monitorohen, procedurat dhe masat teknike të nevojshme, përfshirë, por pa u kufizuar në kërkesat për marrjen e mostrave dhe analizave për secilin parametër, kontrollin e cilësisë, praktikat laboratorike dhe regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave.
3. Rregullorja e Këshillit të Ministrave publikohet në Fletoren Zyrtare

Neni 72

Regjistri i liçencave, autorizimeve, lejeve e konçesioneve

1. Këshilli i Basenit lumor mban Regjistrin ku shënohen të gjitha liçencat, autorizimet, lejet, konçesionet e lëshuara, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Ministria mban, menaxhon dhe përditëson Regjistrin për të gjitha konçesionet e lëshuara nga Këshilli Kombëtar i Ujërave.
3. Në çdo regjistër të paktën duhet të shënohen dhe evidentohen:
 - a) të gjitha të dhënat dhe detajet për të gjitha kërkesat për liçenca, autorizime, leje dhe konçesione të reja të kërkuara në përputhje me këtë ligj ose për ndryshimin, rinovimin, apo heqjen dorë nga ato ekzistuese.
 - b) procedurat e vënies në zbatim të këtyre liçencave, autorizimeve, lejeve;
 - c) regjistri duhet të jetë i hapur për publikun gjatë orarit zyrtar të punës.
4. KKKU me Vendim përcakton dhe specifikon procedurat, sipas të cilave Këshillat e Baseneve lumore i japin Ministrisë të dhënat dhe informacionin që disponojnë në regjistrat e tyre në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Vendimi i KKKU që përcakton këto procedura publikohet në Fletoren Zyrtare.

KREU 16

REGJISTRI I UJËRAVE

Neni 73

Regjistri Kombëtar i ujërave

1. Krijohet Regjistri Kombëtar i Ujërave.
2. STKKU është autoriteti që krijon, menaxhon dhe përditëson Regjistrin e Ujërave.
3. Regjistri Kombëtar i Ujërave do të përmbajë:
 - a. ujërat sipërfaqësore që klasifikohen sipas statusit të tyre kimik dhe statusit të tyre ekologjik;
 - b. zonat e mbrojtura;
 - c. trupat ujqorë tepër të modifikuar;
 - d. lejet e mjedisit për të ushtruar veprimtari që shkarkon ujëra të përdorur në trupat ujqorë;
 - e. zonat e prirura ndaj eutrofikimit dhe zonat vulnerabël ndaj nitrateve;
 - f. zonat ose sipërfaqet e mbrojtura;

- g. zonat e mbrojtjes higjeno-sanitare;
 - h. zonat e mbrojtjes emergjente;
 - i. zonat me mbrojtje të veçantë;
 - j. zonat e rrezikshme për shëndetin;
 - k. konçesionet e dhëna për përdorimin e ujërave;
 - l. trupat ujqorë që përdoren për nxjerrjen e ujit të pijshëm;
4. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, miraton kërkesat, kushtet, procedurat, fondet e nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Regjistrit Kombëtar të ujërave.
 5. Të gjitha institucionet, entet dhe subjektet e tjera publike ose jo publike që merren me menaxhimin e ujërave detyrohen të caktojnë një përfaqësues që mban marrëdhënie me STKKU dhe dërgon të dhënat në Regjistrin Kombëtar të Ujërave në bazë të formave dhe procedurave përkatëse të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave.
 6. Regjistri dhe të dhënat e tij mbahen, menaxhohen dhe përditësohen nëpërmjet sistemit dhe arkivit elektronik.

Neni 74
Regjistri
Funksionet kryesore të Regjistrit

1. Informacioni në Regjistër organizohet sipas të dhënave elektronike të integruara për burimet ujore në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me njëra-tjetrën. Autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e ujërave krijojnë, mbajnë dhe menaxhojnë përkatësisht bazën e të dhënave.
2. Regjistri dhe të dhënat e tij janë të hapura dhe mund të sigurohen në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit. Regjistri është i hapur për publikun, përveç rastit kur informacioni konsiderohet si konfidencial dhe trajtohet dhe mbrohet me ligj të veçantë. Informacioni i dhënë nga Regjistri është përgjithësisht falas, por për shërbime të veçanta mund të aplikohet një tarifë e arësyeshme, për të cilën publiku lajmërohet paraprakisht.
3. Të dhënat e Regjistrit përdoren nga autoritetet dhe institucionet e tjera publike kombëtare ose vendore në përputhje me këtë ligj dhe me akte ligjore e nënligjore të tjera.
4. Çdo institucion regjistron në Regjistër pjesën e vet të të dhënave dhe i publikon ato në faqen e vet elektronike.
5. Autoritetet kombëtare dhe vendore të ujërave kontribuojnë proporcionalisht për krijimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit.

KREU 17
INFORMIMI I PUBLIKUT DHE KONSULTIMI

Neni 75

E drejta për të marrë dhe/ose përdorur informacionin mbi ujërat

1. Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë t'i mundesohet dhenia dhe/ose përdorimi i informacionit të disponueshëm në lidhje me ujërat.
2. Publikut i jepet informacion në lidhje me burimet dhe menaxhimin e integruar të ujërave.
3. Publikut i jepet informacion mbi dokumentet bazë dhe informacionin e përdorur për hartimin e planeve të menaxhimit të baseneve, si dhe i krijohet mundësia për të marrë pjesë në procesin e konsultimit e komentimit të planeve të menaxhimit të baseneve lumore.

KREU 18 DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 76 Tarifat për përdorimin e ujit

1. Këshilli i Ministrave miraton tarifat që paguhen për përdorimin e ujit. Këshilli i Ministrave merr parasysh të paktën këto faktorë:
 - a. lloji i ujit që kërkohet për përdorim;
 - b. qëllimi i përdorimit të ujit;
 - c. stina e vitit, gjatë së cilës përdoret uji;
 - d. sasia e ujit që do të merret;
 - e. nëse uji do të përdoret për konsum njerëzor apo jo;
 - f. zërat e shpenzimeve të planifikimit, ndërtimit, shfrytëzimit, mirëmbajtjes e amortizimit të objekteve ujore dhe të ardhurat e parashikuara për përdoruesin e ujit nga përdorimi i këtij objekti ujqor;
 - g. përshtatshmëria e impianteve për trajtimin dhe largimin e ujit pas përdorimit, në kuptimin e ndikimit mbi shëndetin e njerëzve, cilësinë e ujit e mjedisin.
2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e autoriteteve të ujit, mund të përjashtojë nga pagesat persona të caktuar fizikë a juridikë, shtetërorë ose privatë, kur ky përjashtim i shërben më mirë interesit publik.
3. Autoritetet e ujit mbledhin dhe administrojnë pagesat për tarifat e përdorimit të ujit.

Neni 77 Shpenzimet administrative

1. Kushdo që, pas marrjes së miratimit nga autoritetet përkatëse për përdorimin apo shkarkimin e ujit, për ndërtimin e objekteve a veprave ujore sipas këtij ligji, kërkon të ushtrojë veprimtari detyrohet të paguajë për shpenzimet administrative. Këto pagesa mblidhen nga autoritetet e ujit.
2. Të ardhurat që krijohen nga këto pagesa dhe nga tarifat për përdorimin e ujit përdoren vetëm për qëllime të shfrytëzimit të burimeve ujore në nivel qendror apo vendor, për punë kërkimore-shkencore, për përpunime statistikore, për regjistrat e

ujërave, masat për mbrojtjen nga përmbytjet, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e burimeve ujore dhe për investime të tjera të nevojshme në fushën e përdorimit të ujërave.

3. KKKU miraton tarifat për shpenzimet administrative

Neni 78

Organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit

1. Autoritetet e ujit, njësitë e qeverisjes vendore, strukturat e Ministrisë përgjegjëse për shëndetsinë, për bujqësinë, strukturat dhe organet e emergjencave civile, të rregullimit e planifikimit të territorit janë përgjegjës për marrjen e masave për zbatimin përkatësisht të dispozitave të këtij ligji.
2. Inspektoratet përkatëse janë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.
3. Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit janë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji në përputhje me dispozitat e Ligjit nr... dt... “Për mbrojtjen e mjedisit”.
4. Operatorët e angazhuar në fushën e menaxhimit të ujërave, mbi të cilët zbatohet ky ligj i japin Inspektorëve përkatës që inspektojnë aktivitetin e tyre, të gjithë asistencën e nevojshme për kryerjen e inspektimeve në atë veprimtari, për marrjen, analizimin dhe grumbullimin e gjithë informacionit të nevojshëm për realizimin e detyrave të tyre për qëllime të këtij ligji dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit nr... datë... “Për mbrojtjen e mjedisit”.

KREU 19

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 79

Dënimi dhe Ankimi administrativ

1. Organi administrativ kompetent për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative kur konstaton shkeljen e dispozitave të këtij ligji, të cilat parashikojnë kundërvajtje administrative, pas shqyrtimit, në varësi nga rëndësia dhe shkalla e shkeljes administrative, vendos dënimin me gjobë apo dënime të tjera administrative.
2. Kompetenca për shqyrtimin e kundërvajtjes i takon organit administrativ apo titullarit të organit administrativ që ka konstatuar kundërvajtjen administrative.
3. Dënimi administrativ, në varësi të llojit të kundërvajtjes, mund të shoqërohet edhe me masa administrative parandaluese, sic parashikohen në këtë ligj dhe në Ligjin “Për kundërvajtjet administrative”.
4. Zbatimi i kundërvajtjeve administrative nuk e shmang operatorin përkatës nga detyrime të tjera të përcaktuara në këtë ligj si dhe përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 80

Sanksionet administrative

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si më poshtë:

1. Për ushtrim aktiviteti nga Shpuesit profesionistë të puseve pa pasur liçencë nga QKL të parashikuar në nenin 39, pika 1, kundërvajtësi dënohet me gjobë në masën _____ lekë.
2. Për mosparaqitjen e raportit nga ana e Shpuesit profesionist, në përfundim të shpimit dhe marrja e ujit nga pusi mbi sasinë e shënuar në Licencë, ose përdorimi i tij për qëllime të tjera të parashikuara në nenin 39, pikat 2, kundërvajtësi dënohet me gjobë në masën _____ lekë.
3. Për kryerjen e veprimtarive pa lejet përkatëse në Zonat e mbrojtjes higjieno-sanitare të parashikuara në nenin 40 pika 3, shkronjat b, c kundërvajtësi dënohet me gjobë në masën _____ lekë.”
4. Për shkelje të parashikuara në nenet 49, 51, 54/3,55, lidhur me veprime për mbrojtjen e brigjeve, kryerjen e veprimtarive në brigje pa lejet përkatëse, për kryerjen e veprimtarive të ndaluara në brigje dhe plazhe, për magazinimin e materialeve dhe lëndëve dhe ndërtimin e objekteve të reja në zonat e kërcënuara nga përmbytjet, si dhe për ndërtimin e veprave dhe objekteve ujore pa lejet përkatëse kundërvajtësi dënohet nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, në varësi të shkallës së shkeljes me:
 - a. gjobë _____
 - b. pezullim të veprimtarisë deri në _____
 - c. sekuestrimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës si dhe të materialit inert gjendje të grumbulluar duke i kaluar për ruajtje në rezervat materiale të shtetit.
5. Për shkarkimet në ujë, tokë, nëntokë a në gropa, pa miratimin e lëshuar nga autoriteti i basenit, shkelje e parashikuara në nenin 57, pika 1, kundërvajtësi dënohet me gjobë në masën _____ lekë.
6. Për shkeljet e parashikuara në nenin 62, pika 1/ paragrafët a, b, c, d, e, f, g, i, kundërvajtësi dënohet me gjobë në masën _____ lekë.
7. Për shkelje të parashikuara në nenin 62, pika 1/ paragrafi h) nxjerrja e materialeve të ngurta nga brigjet dhe shtretërit e lumenjve, përrenjve dhe rezervuarëve me ose pa ujë, kundërvajtësi dënohet me gjobë në masën _____ lekë
8. Për shkeljet e parashikuara në nenin 62, pika 2, kundërvajtësi dënohet me gjobë në masën _____ lekë.”

Neni 81

Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative

1. Vendimi për kundërvajtjen administrative bëhet titull ekzekutiv në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga organi administrativ që ka kompetencën për shqyrtimin përfundimtar të kundërvajtjes në rrugë administrative.
2. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarimor në RSH.
3. Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data kur:

- a) kundërvajtësi është njoftuar për vendimin e dënimit me gjobë, që përbën titull ekzekutiv;
 - b) vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë.
4. Kundërvajtësi, për çdo ditë vonesë paguan kamatë në masën 2 % në ditë, deri në --- muaj.
 5. Gjobat dhe detyrimet e tjera të parashikuara në vendim paguhen nga kundërvajtësi pranë organit që ka vendosur gjobën.
 6. Të ardhurat nga gjobat dhe të ardhurat e tjera, të mbledhura në zbatim të dispozitave të këtij ligji kalojnë ___% në Buxhetin e Shtetit, dhe ____% në favor të buxhetit të organit që ka vendosur kundërvajtjen.

Neni 82

Ankimi në rrugë gjyqësore

1. Kundër vendimit për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënim me gjobë, të nxjerrë nga organi i administratës, mund të bëhet ankimi në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
2. Ankimi në gjykatë nuk pezullon ekzekutimin e vendimmarrjes administrative.
3. Për procedurat e ankimit zbatohen rregullat dhe afatet, sipas dispozitave ligjore për kundërvajtjet administrative.

KREU 20

DISPOZITAT TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 83

Propozimi dhe miratimi i akteve nënligjore

1. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në përputhje me këtë ligj, brenda 3 vjetësh nga hyrja e tij në fuqi.
2. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e neneve 9 pika 5, 11 pika 2, 14 pika 6, 16 pika 5, 17 pika 3, 18, 20 pika 1, 21 pika 3, 22 pika 3, 25, 29 pika 3, 31 pika 2, 32 pika 4, 33 pika 1, dhe 6, 35 pika 3, 57 pika 3 dhe 4, 66 pika 3, 67 pika 1, 69 pika 7, 70 pika 2, 71 pika 1, 73 pika 4, 76 pika 1 dhe 2.
3. Ministri është përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e neneve 19 pika 2, 23 pika 2, 30 pika 1., 32 pika 2,
4. Ministri në bashkëpunim me Ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe Ministrin përgjegjës për ekonomine nxjerr rregullore për zbatimin e nenit 30 pika 2.
5. Këshilli Kombëtar i Ujit, Ministri dhe Ministri përgjegjës për shëndetësinë janë përgjegjës për miratimin e aktit nënligjor për zbatimin e nenit 57 pika 2.
6. Ministri në bashkëpunim me Ministrin përgjegjës për Mbrojtjen Civile janë përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e nenit 68 pika 1 .

Neni 84

Aktet nënligjore të caktuara që do të vazhdojnë të jenë në fuqi

Deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, aktet ekzistuese do të vazhdojnë të mbeten në fuqi:

- a. Vendimi nr. 163, datë 30.03.2001 “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së për problemet ujore”;
- b. Vendimi nr. 273, datë 07.05.2004 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të ujit”
- c. Vendimi nr. 23 date 9.1.2008 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit”;
- d. Vendimi nr. 124 date 2.3.2006 “Për krijimin e komisionit qeveritar për problemet ujore me vendet fqinj”;
- e. Vendimi nr. 125 date 2.3.2006 “Për një ndryshim në vendimin nr.775, date 28.10.1996 të Keshillit të Ministrave “Për krijimin e Keshillit Kombëtar të Ujit”, i ndryshuar.

Neni 85

Shfuqizimet

Me bërrjen efektive të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr 8093, datë 21/03/1996 "Për rezervat ujore" i ndryshuar, Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur” si dhe çdo dispozitë tjetër që bie ndesh me parashikimet e këtij ligji.

Neni 86

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 vjet pas pas botimit në Fletoren Zyrtare.